

VENDIMNR. 06/2 DT. 31.01.2019I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
TË SHOQERISË "BANKA CREDINS " SH.A.

Sot, me datë 31.01.2019, në orën 12.00, në selinë e shoqërisë me adresë në Rr. "Vaso Pasha" Nr.8, Tirana, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë BANKA CREDINS SH.A., shoqëri anonime shqiptare, regjistruar në mënyrë të rregullt në Regjistrin Tregtar, me Vendim Nr. 28969, të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Tiranë, datë 31.01.2003 (referuar më poshtë si "Shoqëria").

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme iu njoftua të gjithë aksionerëve, në mënyrë të rregullt në respekt të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit të Shoqërisë, me datën 10.01.2018, me anë të postës së Bankës dhe po atë datë u publikua edhe në faqen e bankës ne internet www.bankacredins.com. Njoftimi u shoqërua në mënyrë të rregullt nga dokumentacioni përkatës i mbledhjes.

Ishin të përfaqësuar në Mbledhje 31% e Kapitalit të Shoqërisë, e vërtetuar nga Lista e Pjesëmarrjes, e cila u nënshkrua nga të gjithë të pranishmit. Si konkluzion, Kuorumi i nenit 144 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me më shumë se 50% të kapitalit, është përmbushur. Mbledhja merr vendime me $\frac{3}{4}$ e aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

Mbledhja e Asamblesë u drejtua nga z. Maltin Korkuti. Sekretar i Mbledhjes u caktua znj. Dora Vako.

Rendi i dites:

1. Propozim për rritjen e kapitalit të Bankes Credins në masën 4 milion Euro nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja.
2. Ngarkohet Drejtoria të bëjë njoftimet dhe regjistrimet përkatëse në përputhje me Ligjin.

Asambleja e Përgjithshme pasi konfirmoi kompetencën e saj për të vendosur duke u bazuar në Ligjin Nr 9662, datë 18.12.2006 " Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe në Statutin e shoqërisë, në formën e vendimit:

VENDOSI

1. Të zmadhohet kapitali i "BANKES CREDINS" SH.A. në vlerën 4,000,000 euro (katër milion euro) nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja. Në total numri i aksioneve që do të emetohen është 2.450.981 aksione me book value per aksion 1.632 eur /aksion.(book value per aksion është llogaritur mbi kapitalin e bankes sipas pasqyrave financiare IFRS date 31.12.2018 te pa certifikuara). Afati per te ushtruar te drejtën e parablerjes nga aksioneret e Bankes do te jete jo me vone se 20 dite pas publikimit te njoftimit per zmadhimin e kapitalit ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit, e drejte kjo qe do te materializohet me nënshkrimin e aksioneve te reja, ne te kundërt aksioneret humbasin te drejtën e nënshkrimit. Ne rast se aksionaret ekzistues heqin dore nga e drejta e perparësise, ose e humbasin ate me kalimin e afatit 20 ditor, aksionet e panënshkruara mund t'i ofrohen personave te trete Afati për shlyerjen e aksioneve te reja te nënshkruara, caktohet te jete brenda dates 31.12.2019

2. T'i delegeje Drejtorisë te gjitha kompetencat e nevojshme per te realizuar te gjitha procedurat ne lidhje me kompletimin e transaksioneve te mësipërme, per te fiksuar modalitetet, per te gjetur investitore te mundshëm, per te nënshkruar kontratat e nënshkrimit, per te njoftuar Bankën e Shqipërisë lidhur me zmadhimin e kapitalit, si dhe per te bere regjistrimet përkatëse prane Qendrës Kombëtare te Biznesit dhe Qendrës se Regjistrimit te Aksioneve.

AKSIONARËT E SHOQËRISË

Aleksandër PILO



Emi SANTO

B.F.S.E Holding BV
përfaqësuar nga Xhet Hushi



Neritan DOJAKA

Renis TËRSHANA



Alba THOMOLLARI

Unioni Shqiptar Kursim Kredie
përfaqësuar nga



Fadil ALLAJBEU



Monika MILO

Astrit HANA

Fuad HAXHIYMERI

Jorgjia BALLI



Akil ALIZOTI

Leonat KOCO



Veneranda BUSHATI

Edmond REXHO

Ilirjan BUSHATI

Elena HAXHIYMERI

Maltin KORKUTI

Elisabeta HYSI

Amryta Capital LLP
përfaqësuar nga Xhet Hushi

Pandeli GARO

Bardhi HOXHA

A.F.C sh.p.k
përfaqësuar nga

Egi SANTO

Albens BUSHATI

Aida BUSHATI

Tefik KOKONA

Viollca BUSHATI

AK-INVEST sh.a.
përfaqësuar nga

Mirela NDINI

Andon DAKA

EDRO sh.p.k
përfaqësuar nga

Arjan HANA

Edita DOPPELMAIR

Robert KASNECI

PRIMA SHPK
përfaqësuar nga

Helidon KOKONA

Hajrulla KALO

Lorenc BEJKO

Dritan TODHE

Fatmira DINA

Emond HOXHA

Mira MEKSI

Robert LUKAJ

Elvira BABOCI

Suela HOXHA

Gjergj BUSHATI

VENDIM I ORTAKUT TE VETEM TË SHOQËRISË

"A.F.C." SH.P.K

Sot, më date 31.01.2019, në Seline e Shoqërisë, në Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 2, Rruga Themistokli Gërmenji, Nr. 2, Objekti Nr. 173, Ortaku i Vetem i shoqërisë tregtare "A.F.C." Sh.p.k., e regjistruar në Regjistrin Tregtarë Gjykatës së Rrethit Tiranë me Vendimin nr. 1007, datë 20.01.2004, me NUIS J61824006C, vendosi si më poshtë:

Autorizohet Z. Shpendi Sejdarasi të marrëpese në mbledhjen e aksionarevete "Banka Credins" sh.a, që do të organizohet më date 31.01.2019, për të nënshkruar listprezencën, vendimin e Asamblese dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm në këtë mbledhje me rend ditesi më poshtë:

1. Miratimi i veprimeve të organeve dhe/ose strukturave që kanë vepruar në emer dhe për llogari të Bankes Credins për marrjen në pronësi të kolateraleve të debitoreve të Bankes Credins si rezultat i procesit përbarimor.
2. Autorizohet Drejtoria të ndjeke të gjitha hapat ligjore dhe të nënshkruajë çdo akt, kërkesë, aplikim, kontratë, etj., deri në kompletimin e procesit të marrjes në pronësi të pasurisë së sipërmendur në pikën 1.
3. Propozim për rritjen e kapitalit të Bankes Credins në masën 4 milion Euro nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja.
4. Ngarkohet Drejtoria të bëjë njoftimet dhe regjistrimet përkatëse në përputhje me Ligjin

ORTAKU I SHOQËRISË

Shpendi SEJDARASI

Shpendi Sejdarasi
A F C
imp exp
TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE, TIRANË

NR. 253 REP

NR. 108 KOL

2

PROKURE E POSAÇME



Sot më datë 26.01.2019 (dymijë e nentembdhjete), para meje Noterit, Lorenc Daka, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, me seli ne Bulevardin "Gjergj Fishta" p.6, zyra nr.15 Tirane, prane Gjyqates se Rrethit Gjyqesor Tirane, u paraqit:

Z. Aleksander Pilo, atesiaKoço, lindur me 08.04.1963, lindur dhe banues në Tiranë, madhordhe me zotësitëplotëjuridikepërtëvepruar, identifikuar me letërnjoftiminelektronik me nr. 024396300, dhe me nr. Personal G304082200,i cili me vullnetin e tij të plotë dhe të lirë më kërkoi redaktimin e kësaj prokure të posaçme si më poshtë vijon:

"Emëroj si përfaqësues të posaçëm **Z. Egi Santo**,lindur më date 04.06.1988, banues në Tirane, identifikuar me Leternjoftim me nr. Personal I80604062U, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, të cilit i jap të drejtë të më përfaqësojë në mbledhjen e datës 31.01.2019 të Asamblesë së Pergjithshme të shoqërisë tregtare "BANKA CREDINS" Sh.A., e regjistruar në Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me Vendimin nr. 28969, datë 31.01.2003, me rend dite si më poshtë:

1. Miratimi i veprimeve të organeve dhe/ose strukturave qe kane vepruar ne emer dhe per llogari te Bankes Credins per marrjen në pronesi te kolateraleve te debitoreve te Bankes Credins si rezultat i procesit permbarimor.
2. Autorizohet Drejtoria te ndjeke te gjitha hapat ligjore dhe te nenshkruaje cdo akt, kerkese, aplikim, kontrate, etj., deri ne kompletimin e procesit te marrjes ne pronesi te pasurise se siperpermendur ne piken 1.
3. Propozim per rritjen e kapitalit te Bankes Credins ne masën 4 milion Euro nëpërmjet emetimit te aksioneve te reja.
4. Ngarkohet Drejtoria te beje njoftimet dhe regjistrimet perkatese ne perputhje me Ligjin

Kjo prokurë do të ketë fuqi per përfaqësimin tim në mbledhjen e asamblesë date 31.01.2019, si dhe për mbledhjet vijuese te asamblesë me te njëjtin rend dite."

Sa më sipër, është një prokurë e redaktuar prej meje noterit, bazuar në nenin 71 të Kodit Civil, dhe konform vullnetit të palëve.

Prokura iu lexua të përfaqësuarit me zë të lartë dhe pasi u gjet konform vullnetit të tij të lirë e të plotë, u nënshkrua rregullisht. Kjo prokurë e posaçme u përpilua në tre kopje origjinale dhe të njëjta.


I PËRFAQËSUARI

Aleksandër PILO

NOTERI

Lorenc Daka

DEPINNA
NOTER



Unë, James Sion TAYLOR, Noter në Qytetin e Londrës, Angli, i pranuar dhe i betuar sipas rregullave nga Autoriteti Mbretëror, që ushtror këtë profesion në qytetin e lartpërmendur,

VËRTETOJ DHE DEKLAROJ PËRMES KËSAJ PROKURË

Se firma e vendosur dhe e shkruar në fund të kësaj Prokure te Posaçme për dhe në emër të shoqërisë AMRYTA CAPITAL LLP, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, e themeluar dhe e cila e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin e Anglisë, e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Subjekteve të Anglisë dhe Uellsit me Nr. OC369471, me seli në adresën: Level 5, Berkeley Square House, Berkeley Square, Londër W1J 6BY, Angli, është firma origjinale e RAHUL MEHTA, një prej Anëtarëve të Caktuar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara, identiteti i të cilit u vërtetua prej meje;

SE nënshkrimi i vendosur dhe i shkruar në fund të Prokurës në fjalë, e cila i përket dëshmitares që ka nënshkruar, është firma origjinale e VERONIKA KOSTRNOVA, identiteti i së cilës u vërtetua prej meje;

Dhe se Kjo Prokurë e Posaçme, e nënshkruar dhe e vërtetuar prej meje, është e detyrueshme për shoqërinë e lartpërmendur AMRYTA CAPITAL LLP në përputhje me dispozitat e legjislacionit anglez.

SI PROVË E KËSAJ UNË kam hedhur firmën time në këtë deklaratë dhe kam vendosur vulën e Zyrës në qytetin e Londrës, përmendur më lart, më njëzet e pesë janar të vitit dy mijë e nëntëmbëdhjetë.

JAMES SION TAYLOR
Noter në Londër, Angli

APOSTILLE

(Konventa e Hagës 5 Tetor 1961)

1. Vendi: Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut	
Ky dokument publik	
2. Është nënshkruar nga James Sion Taylor	
3. Vepron në cilësinë e Noterit Publik	
4. Mban vulën/stampën e Noterit të lartpërmendur	
Vërtetimi është lëshuar	
5. Në Londër	6. Më 28 Janar, 2019
7. Nga Sekretari i Shtetit i Madhërisë së Saj për Punët e Jashtme dhe të Komënuelthit	
8. Numër APO-1279151	
9. Vula	10. Firma P. Forbes

Kjo apostille nuk përdoret në Mbretërinë e Bashkuar dhe konfirmon vetëm vërtetësinë e firmës, vulës ose stampës në dokumentin publik të lëshuar në Mbretërinë e Bashkuar. Nuk konfirmon vërtetësinë e dokumentit në fjalë. Apostilet bashkëlidhur dokumenteve të fotokopjuar dhe të certifikuar në Mbretërinë e Bashkuar konfirmojnë firmën e nëpunësit publik i cili vetëm ka kryer certifikimin. Nuk siguron në ndonjë mënyrë vërtetësinë e firmës në dokumentin origjinal dhe përmbajtjen e dokumentit origjinal.

Nëse ky dokument do të përdoret në një shtet i cili nuk bën pjesë në Konventën e Hagës së 5 Tetorit 1961, duhet t'i paraqitet konsullit të misionit që përfaqëson atë vend.

PROKURE E POSACME

Nënshkruesi:

Amryta Capital LLP., nje subjekt i huaj ligjor, i themeluar ne Londer, me seli ne adresen: Level 5, Berkeley Square House, Berkeley Square, Mayfair, W1J 6BY, me numer regjistrimi Nr. OC369471, i cili vepron ne cilësinë e aksionerit te "Banka Credins" SH.A. ("shoqeria")

Deklaron se jep të drejtë të pakthyeshme si më poshtë:

Z. Sokol Nako ose Xhet Hushi, në emër dhe për llogari të nënshkruesit, të marrë pjesë në Mbledhjen e Aksionerëve të Shoqerise datë 31.01.2019 dhe, të nënshkruajë listprezencën dhe vendimet e Asamblesë së Aksionerëve të Shoqerise, mbi çështjet e mëposhtme:

1. Miratimi i veprimeve të organeve dhe/ose strukturave qe kane vepruar ne emer dhe per llogari te Bankes Credins per marrjen në pronesi te kolateraleve te debitoreve te Bankes Credins si rezultat i procesit permbarimor.
2. Autorizohet Drejtoria te ndjeke te gjitha hapat ligjore dhe te nenshkruaje cdo akt, kerkese, aplikim, kontrate, etj., deri ne kompletimin e procesit te marrjes ne pronesi te pasurise se siperpermendur ne piken 1.
3. Propozim per rritjen e kapitalit te Bankes Credins ne masën 4 milion Euro nëpërmjet emetimit te aksioneve te reja.
4. Ngarkohet Drejtoria te beje njoftimet dhe regjistrimet perkatese ne perputhje me Ligjin.

Gjithashtu, perfaqesuesi ka te drejte te nenshkruaje te gjitha dokumentet qe konsiderohen si te nevojshme per permbushjen e qellimit te kesaj procure te posaçme.

Nenshkruar ne Londer me 25/01/2019

Nenshkrimi i Rahul Mehta
Drejtore
Amryta Capital LLP

Ne prani te:
Nenshkrimi i Deshmitares:
Emri i Deshmitares: Veronika Kostrova
Adresa e deshmitares:
51 William Guy Gardens, London, E3, 3LF
Data: 25/01/2019
Profesioni: Sekretare

Përkthyes: Manjola Çraga

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES
Nr. 1202 Rep.

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Vertetohet firma e perkthyeses Manjola Çraga, e njohur personalisht prej meje, e cila me deklaroi se perktheu njelloj si origjinali nga gjuha angleze ne gjuhen shqipe Prokuren e Posacme nenshkruar me date 25/01/2019 ne Londer nga Administratori i shoqerise Amryta Capital LLP, Rahul Mehta.

Tirane, me 06.02.2018

REPUBLIC OF ALBANIA
NOTARY OFFICE OF TIRANA
Nr. 1202 Rep.



NOTER
Julian ZHELEGU

CERTIFICATION

We hereby certify the foregoing signature of the translator Manjola Çraga, known to me personally and who declared of having translated from English into Albanian the Power of Attorney signed on date 25/01/2019 in London by the Administrator of the company Amryta Capital LLP, Rahul Mehta.

Tirana, 06.02.2018

NOTARY
Julian ZHELEGU

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 1203 Rep.

Tirane, më 06.02.2019

**VËRTETIM
I NJËSISË ME ORIGINALIN**



Unë, Noter Julian Zhelegu, anëtar i Dhomës së Noterisë Tirane, me seli në Rr. "Pjeter Bogdani",
vërtetoj se njësia bashkëlidhur është kopje e njëjte me dokumentin original.

Dokumenti është Prokure e posacme e leshuar nga Amryta Capital LLP, date 25.01.2019.

Dokumenti u paraqit nga Znj. Zhaneta Bedaj, e njohur prej meje noterit.

Vërtetimi i dokumentit u bë në bazë të nenit 56, të ligjit nr. 7829, date 01.06.1994 "Për Noterinë" (i ndryshuar) dhe pikave 3,4,7 të Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr. 6291, date 17.08.2005.

**NOTER
JULIAN ZHELEGU**

